

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“ Marbella Beach Hotel ” SH.P.K**

Sot më **datën 27/01/2021**, ne shtetasit :

**Z. Ozvalto Dollija**, biri i Astrit-it dhe Pranvera-s, i datëlindjes 29/09/1972, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rruga “ Frosina Plaku”, Njësia Administrative Nr. 7, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,dhe

**Zj. Jorida Mema**, bija e Muharrem-it dhe Feriha-s, e datëlindjes 21/03/1980, Lindur në Durrës dhe banuese në Lagjen Nr. 4, Rruga “Hafiz Podgorica”,Durrës.

Vendosëm të themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“Marbella Beach Hotel ” SH.P.K** si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Personat fizik të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar ( SH.P.K ) me emertimin **“Marbella Beach Hotel ” SH.P.K**

Ortak të kësaj shoqërie janë **Z. Ozvalto Dollija dhe Zj. Jorida Mema.**

Administrator të kësaj shoqërie do të jenë **Z. Ozvalto Dollija dhe Zj. Jorida Mema.**

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vëndit në çdo kohë që do të çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria **“Marbella Beach Hotel ” SH.P.K**, gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. **Qendra e saj ndodhet në adresën: Bulevardi i Pishave 2025, Golem , Kavajë, në pasurinë Nr. 111/421, ZK 2291.**

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen : **“Marbella Beach Hotel ” SH.P.K**


**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë 5 vjeçar.

**Neni 4**

Shoqëria **“Marbella Beach Hotel ” SH.P.K** do të ketë si objekt veprimtarie si më poshtë :

Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hoteleri, bar restorant, beach bar, me plan shërbimi të personalizuar dhe plan shërbim “çdo gjë e përfshirë ” (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, pistë në det me lokacion bar restorant, vendbazim për mjete ujore, motorike dhe jo



motorike, transport organizim I tureve, guidave të ndryshme turistike, zhvillim I panairëve, seminareve dhe work-shopeve, shërbime opsionale plotësuese me karakter ç'lodhje, pushimi apo dëfrimi, spektakli, lojëra, organizime dhe realizime "event-esh" të ndryshme, shërbimi spa, shërbim parkimi, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë .

#### **Neni 5**

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është **100.000 (Një qind mijë) Lekë.**

#### **Neni 6**

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie i përket në masën **60 % ortakut Ozvalto Dollija dhe 40 % ortakut Jorida Mema.**

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortakët e saj nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Themeluesit e shoqërisë pasi e lexuan me vëmendje akt themelimin e mësipërm dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e firmosën pa vërejtje.

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

Ozvalto DOLLIJA

Jorida MEMA

Ozvalto Dollija  
Jorida Mema